



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 10 Janar 2017

NJOFTIM

Në mënyrë të përsheptuar zhvillohet realizimi i projekteve të lëmisë farmaceutike

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë do të mundësojë të jepen me recetë barnat antikoagulant respektivisht barnat e listës spitalore **'kleksan'** dhe **'fraksiparin'** të cilat, sipas procedurës së rregullt refundohen; do të mundësojë terapi tremujore për personat me sëmundje kronike dhe lokator për gjetjen e barnatores më të afërt dhe institucionit shëndetësor (që ka marrëveshje me Fondin) më të afërt.

Këto janë projektet e lëmisë farmaceutike të cilat u shqyrtuan në takimin e sotshëm mes drejtorëve të Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë, Orhan Ramadanin dhe d-r Sasho Stefanoskin dhe kryetaren e Odës farmaceutike të maqedonisë, prof.Bistra Angelovska së bashku me shërbimet profesionale të të dy institucioneve.

Politika e Fondit është të jetë transparent, i koordinuar dhe në sinkronizim me të gjitha shoqëritë 'esnafe' dhe të atyre që mund të kontribuojnë për realizimin e idejave dhe projekteve të caktuara ku do të jenë të kyçur persona profesional prej të gjitha odave.

Drejtori d-r Sasho Stefanoski theksoni se është e nevojshme të vijmë në një zgjidhje të arsyeshme që nënkupton zbatimin e këtyre ideve nëpër terene, përmirësimin e kushteve dhe të drejtës së pacinetëve sa i përket Ligjit për kujdes shëndetësor. Drejtori informoi se Fondi në bashkëpunim me Odën farmaceutike bisedojnë për një numër më të madh të projekteve të rëndësishme të cilat kanë për qëllim rritjen e sasisë së barnave për të siguriarit. Sa i përket projektit për terapinë tremujore të pacientëve me sëmundje kronike, theksoi se do të shkëmbejnë mendime për të gjetur zgjidhjen dhe metodologjinë më të përshtatshme që do mund të zbatohet dhe njëkohësisht të reflektojë e arsyeshme tek të siguriarit dhe barnatorët. Do t'i zhvillojmë kriteret e nevojshme, do të mendojmë si t'a implementojmë më shpejt këtë projekt, t'a realizojmë premtimin ashtu që në fund të kuartalit të parë të vitit 2017, ky projekt të jetë operativ dhe të siguriarit të fillojnë t'i shfrytëzojnë dobitë e tij.

Projekti i tretë është i lidhur me sektorin e IT dhe ka të bëjë me lehtësimet gjatë kërkimit të institucioneve shëndetësore publike dhe private sidomos barnatoreve që kanë marrëveshje me Fondin. Drejtori d-r Sasho Stefanoski potencoi se planifikohet të krijohet aplikacion i rij për shfrytëzuesit e smartfonave ashtu që të siguriarit do mund t'a gjejnë barnatoren më të afërt nga lokacioni ku gjenen ose vendi ku ata jetojnë, të informohen se cila barnatore është e hapur, cila është barnatorja kujdestare,etj.

Drejtori i Fondit për sigurim shëndetësor Orhan Ramadani njoftoi se në vitin 2015 Fondi për barin kleksan ka paguar mjete në vlerë rreth 10 milion denarëve. Tash besoj se kemi gjetur një mënyrë më të përshtatshme për t'u furnizuar me kleksan në fakt, të siguriarit do mund t'a marrin kleksanin ose fraksiparinin e përshkruar në recetë drejtpërdrejt nga barnatorja.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Prof. Angelovska i përkrahu projektet e Fondit të cilat i vlerëson si projekte shumë objektive që kanë qëllim përmirësimin e furnizueshmërisë që pacientëve me barna si dhe përmirësimin e kushteve të punës nëpër barnatore. Në takim gjithashtu u bisedua edhe për problemet dhe vërejtjet që rrjedhin nga puna praktike respektivisht nga nevojat e të punësuarve mjekësor nëpër barnatore.